



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT

**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit - Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN), më datë **07.10.2014**, realizoi **vizitë të rregullt** në Institucionin Publik Azili i Pleqve “Zafir Sajto” në Kumanovë. Kjo vizitë u realizua në bashkëpunim me Shoqatën e Punonjësve Social të Qytetit të Shkupit dhe Shoqatën e Infermiereve, Mamive dhe Teknikëve të RM-së. Ky Institucion është i llojit të hapur dhe në të shfrytëzuesit vendosen mbi bazë vullnetare, kështu që fokusi u vu mbi kushtet materiale në të cilat janë vendosur, kujdesin përkatës shëndetësor, si dhe mbrojtjen sociale, si parakushte të cilat nevojiten për trajtim human dhe dinjitoz me personat e moshuar.

Fillimisht, MPN-ja zhvilloi bisedë me ekipin profesional të këtij Institucioni, më pas zbatoi inspektim në kapacitetet e vendosjes dhe zhvilloi bisedë me një numër të madh të shfrytëzuesve të vendosur në këtë Azil. Në fund të vizitës u zhvillua bisedë me drejtorin e Institucionit, të cilit iu prezantuan perceptimet dhe konstatimet fillestare me paralajmërimin se për vizitën do të përgatitet dhe dërgohet raport i veçantë.

Mekanizmit Parandalues Nacional nuk iu paraqitën ankesa për torturë ose lloje tjera të trajtimit brutal, johuman ose nënçmues. Megjithatë, një pjesë e shfrytëzuesve, veçanërisht personat e palëvizshëm u ankuan se pamjaftueshëm kujdesen për ta, si dhe se higjiena në ambientet në të cilat janë të vendosur nuk është në nivel të kënaqshëm. Kushtet materiale dhe higjiena në gjeriatri (ku janë të vendosur shfrytëzuesit e palëvizshëm) nuk janë në nivel të kënaqshëm dhe nevojitet përmirësimi i të njëjtave, ndërsa njëkohësisht MPN-ja konsideron se nevojitet edhe rinovimi i hapësirave të caktuara në pjesën e nyjave sanitare dhe zëvendësimin e pllakave të rena.

Në përbërje të objektit të vjetër është ndërtuar një pjesë e re shtesë, në të cilën MPN-ja zbatoi inspektim në disa dhoma gjumi, me ç’rast konstatoi se në të gjitha ambientet e vizituara higjiena është në nivel të kënaqshëm. Ambientet ishin pajisur në mënyrë përkatëse dhe bukur, me krevate të rinj, dyshekë të rinj, dollapë të rinj, në to kishte shtroje të pastër e të rregullt e cila, sipas informatave që morëm, ndërrohet me rregull. Dyshemeja e hapësirave ishte shtruar me laminat, në të njëjtat ishin vendosur trupa ngrohës (radiatorë) dhe dritare të reja. Secili ambient kishte banjën dhe dushin e vet, të njëjtët ishin të rinj, ndërsa higjiena në to ishte në nivel të kënaqshëm.

Në Institucion, përveç personave të moshuar, përkujdesen edhe grupe të tjera sociale vulnerable. Përkatësisht në Institucion ka të vendosur 10 persona, të cilët janë të nën moshën 65 vjeçare, të cilët u përkasin grupeve sociale vulnerable (të pastrehë, persona pa familje, persona me inferioritet intelektual, persona me çrregullimi psikike) të vendosur përmes QPS për shkak të mospasjes së institucioneve përkatëse.

Për gjendjet e hasura, si dhe rekomandimet e dhëna u përgatit dhe u dërgua raport deri te Azili i Pleqve dhe deri te Ministria kompetente për Punë dhe Politikë Sociale.